



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1200/4 prot.

Datë 19.05.2026

V E N D I M
Nr. 667/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.05.2026 me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a me adresë Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30-12-2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II.2. Në datën 30-01-2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 12.02.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.“ENTECH.AL” SHPK

0.00 lekë Skualifikuar

2.“PC STORE” SHPK

41,104,999.50 lekë Skualifikuar

(f- 2 specialistë të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione ndërkombëtare ose ekuivalent Kjo pike nuk permbushet sepse certifikimet e vetedeklaruara jane per: "Active Directory Management & Security – One Identity (Sales/Accreditation)" -> trajnim/certifikim për menaxhim & siguri të Active Directory / identity security, jo arkiva digjitale. "IT Management – Softëare and Databases” (ID: 37383333) -> është kurs/certifikim i përgjithshëm për IT management dhe sisteme informative, jo "digital archiving/records management". "Databases – DML Statements and SQL Server Administration" (ID: 1429 37383333) -> SQL/administrim databazash, jo arkiva digjitale. "Technical Specialist ... One Identity / OneLogin / Quest"-> sërish Identity & Access Management / platform management, jo arkivim digjital. (certifikim/eksperiencë IAM në profile profesionale.) "Microsoft Certified: Azure Administrator Associate" -> administrim cloud (Azure), jo menaxhim arkivash digjitale. Pra, nuk ka përputhje me kërkesën "Menaxhimi i Arkivave Digjitale" (që nënkupton: digital preservation, records management, metadata, ingest, access, lifecycle, standarde arkivore, etj.). Disa Trajnime qe kane lidhje me Arkiven Dixhitale: DAS (Digital Archives Specialist) - Society of American Archivists (SAA) ICA Managing Digital Archives - International Council on Archives Graduate Certificate in Digital Archives Management - Universitete të ndryshme (McGill, SJSU, Liverpool, etj.) MARM Digital Pathëay - Master në Menaxhimin e Arkivave dhe Dokumenteve (rruga digjitale).

3.“ATOM” SHPK

51,325,000.00 lekë Kualifikuar

II.4. Në datën 17-02-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak të procedurës së prokurimit.

II.5. Në datën 26.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi

elektronik A/2026/6366 dhe me nr. 609/2026 prot., datë 26.02.2026 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.609/1 prot, datë 26.02.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik, ka përcjellë me shkresën nr. 2025/3 prot., datë 04.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 609/2 prot., datë 06.03.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.8. Në datën 10.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 369/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
3. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

II.9. Me shkresën nr. 2533/2 prot., datë 30.03.2026, protokolluar me tonën nr. 609/7 prot., datë 02.04.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a, ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr.

369/2026 datë 10.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II.10. Në datën 10.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 369/2026, ku vendosi:

1. *“Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30 01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.*
 2. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

II.11. Në datën 10-04-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraparak të procedurës së prokurimit pas rivlerësimit të saj si më poshtë:

1.“ENTECH.AL” SHPK

0.00 lekë Skualifikuar

2.“PC STORE” SHPK

41,104,999.50 lekë Skualifikuar

(Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka konkluduar se nga kontrolli dhe vleresimi i dokumentacionit te dorezuar, rezulton se ky operator ekonomik nuk plotesohen te gjitha kerkesat e nenit 26/6 te VKM 285 date 19.05.2021 i ndryshuar.

Konkretisht nga kontrolli i certifikikatave te dorezuara per stafin teknik ne permbushje te vetedeklarimit shtojca 8, KVO konstaton se :

Pika f) – “2 specialistë të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione ndërkombëtare, ose ekuivalent”

1) Çfarë kanë sjellë fizikisht (për këtë pikë)

a) One Identity (by Quest)

** Active Directory Management & Security – Presales Accreditation (A. B)*

b) Alison (CPD)

** IT Management – Software and Databases (A. B / R.Sh)*

** Databases – DML Statements and SQL Server Administration (A. B.)*

c) One Identity / OneLogin

** One Identity – OneLogin – Technical Specialist (R. K.)*

d) Quest

* Microsoft Platform Management Sales Accreditation (R. K.)

e) Microsoft

* Microsoft Certified: Azure Solutions Architect Expert (L. Q.)

2) Pse nuk pranohet si “Menaxhim Arkivash Digjitale” / “ekuivalent” (arsyetim teknik i drejtpërdrejtë)

Këto certifikime janë të fushave:

* Identity & Access / Active Directory / OneLogin (siguri/akses identiteti),

* Databaza & SQL administration,

* Cloud/Infrastructure (Azure),

* Platform management / sales accreditation.

Ndërsa “Menaxhim Arkivash Digjitale” nënkupton certifikim në disiplinën e:

* records/digital archives management (menaxhim dokumentesh/records),

* metadata & klasifikim, retention/afate ruajtjeje, ruajtje afatgjatë/preservim, akses & audit trail,

* standarde/praktika arkivore.

Pra, edhe pse disa prej tyre mund të jenë komponentë IT që ndihmojnë një sistem, nuk janë certifikime të fushës së arkivave digjitale dhe nuk dëshmojnë 2 specialistë në “digital archives/records management”.

3) Çfarë certifikimesh do të pranoheshin si “ekuivalente” (shembuj emrash certifikimesh)

Këtu janë llojet/emrat tipikë që do të konsideroheshin “ekuivalente”, sepse lidhen drejtpërdrejt me records/archives/digital preservation:

· Digital Archives Specialist Managing Digital Archives

· Digital Preservation / Digital Preservation Management

· Records Management (p.sh. “Certified Records Manager (CRM)” ose “Records Management Certificate”)

· Document & Records Management (DRM)

· Information Governance (me fokus records/archives)

Electronic Records Management / Electronic Document & Records Management

Enterprise Content Management (ECM) / Document Management (certifikim profesional, jo thjesht product-training IT)

Keto janë disa lloje certifikimesh që pranohen për “equivalence”: çelësi është që certifikimi të jetë

qartazi në “archives/records/digital preservation/records lifecycle”, jo në AD/Cloud/DB/Netëork.

Pika a) – “1 specialist i certifikuar për Menaxhim Projektsh PMP, PRINCE2 ose ekuivalent”

1) Çfarë kanë sjellë fizikisht (për këtë pikë)

R. Sh – Project Management (Program Diploma / kurs) – International Business Management Institute (Berlin, Germany)

A. B– Project Management Fundamentals: Approaches and Frameworks Overview

(Alison/CPD)

2) Pse nuk pranohet si PMP / PRINCE2 ose “ekuivalent”

Kërkesa kërkon certifikim të standardizuar PMP (PMI) ose PRINCE2 (AXELOS), ose një certifikim profesional të barasvlershëm, që zakonisht ka:

provim i formalizuar dhe i standardizuar nga organ certifikues i autorizuar,

kornizë metodologjike/standard i njohur ndërkombëtarisht (p.sh. PRINCE2 si metodologji procesuale; PMP i bazuar në kornizat/standarde të PMI/PMBOK),

verifikueshmëri (ID/registry) dhe vlefshmëri e kontrollueshme, kërkohet eksperiencë e dokumentuar në menaxhim projektesh.

Certifikatat e paraqitura fizikisht janë të natyrës kurs/trajnim/program-diploma (“Fundamentals/Overvieë”, “Program diploma”) dhe nuk dëshmojnë qartë një certifikim standard në nivel PMP/PRINCE2, as një ekuivalencë të dokumentuar me provim/standard të krahasueshëm.

Për rrjedhojë, pika (a) konsiderohet e paplotësuar vetëm mbi bazën e dokumenteve fizike të dorëzuara.

3) Çfarë certifikimesh do të pranoheshin si “ekuivalente” (disa shembuj)

PMP – Project Management Professional (PMI)

PRINCE2 Foundation / PRINCE2 Practitioner (AXELOS/PeopleCert)

CAPM – Certified Associate in Project Management (PMI) (shpesh pranohet si nivel certifikimi në PM, në varësi të interpretimit “ekuivalent”)

IPMA Level D/C/B/A (IPMA – International Project Management Association)

PMI-ACP (Agile Certified Practitioner) (pranohet “ekuivalent” në menaxhim projektesh por jo domosdoshmërisht si kërkesë klasike)

Thelbi i “ekuivalent”: certifikim profesional me provim dhe organ certifikues të njohur, jo thjesht certifikatë pjesëmarrjeje në kurs. Pika (f) – përshkrim i shkurtër :

NUK plotësohet. Dokumentet fizike të paraqitura përfshijnë certifikime në Identity & Access/Active Directory, SQL/Databaza, Cloud (Azure) dhe Platform management/sales accreditation. Këto nuk janë certifikime në Menaxhimin e Arkivave Digjitale / Records Management (metadata, klasifikim, retention, ruajtje afatgjatë/preservim, audit trail) dhe si rrjedhojë nuk provohen 2 specialistë të certifikuar në këtë fushë.

Pika (a) – përshkrim i shkurtër.

NUK plotësohet. Certifikatat e paraqitura janë të natyrës edukative (kurs/diplomë) dhe nuk dëshmojnë certifikim profesional të barasvlershëm me PMP (PMI) ose PRINCE2 (AXELOS/PeopleCert). Këto të fundit vërtetojnë kompetencë të standardizuar përmes ekzaminimit zyrtar dhe, në rastin e PMP, kërkojnë edhe eksperiencë të dokumentuar; elemente që nuk rezultojnë nga dokumentet e paraqitura.

3.“ATOM” SHPK

51,325,000.00 lekë Kualifikuar

II.12. Në datën 20.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6559 dhe me nr. 1200/2026 prot., datë 20.04.2026 e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.13. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1200/1 prot, datë 21.04.2026, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.14. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik, ka përcjellë me shkresën nr. 3978/3 prot., datë 30.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 1200/2 prot., datë 30.04.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.15. Më datë 04.05.2026 me shkresën nr.1200/3 nga Komisioni i Prokurimit Publik u dërgua kërkesa për informacion të autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Perqendruara, në lidhje me dorëzimin e dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues për trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik, për procedurën objekt – ankimi.

II.16. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK në këtë procedurë prokurimi, më datë 05.05.2026 ka dorëzuar argumente shtesë në formë shkresore/në sistemin e ankesave elektronike, protokolluar me tonën me nr.1200/4, datë 06.05.2026 me objekt “Argumenta shtesë”.

II.17. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar ka përcjellë me shkresën nr. 4455/1 prot., datë 07.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1200/5 prot., datë 11.05.2026, informacionin e kërkuar nga KPP mbi trajtimin e ankesës dhe dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitura prej tyre, me pretendimin se: “...Pika a) NUK plotësohet. Certifikatat e paraqitura janë të natyrës edukative (kurs/diplomë) dhe nuk dëshmojnë certifikim profesional të barasvlershëm me PMP (PMI) ose PRINCE2 (AXELOS/PeopleCert). Këto të f undit vërtetojnë kompetencë të standardizuar përmes ekzaminimit zyrtar dhe, në rastin e PMP, kërkojnë edhe eksperiencë të dokumentuar; elemente që nuk rezultojnë nga dokumentet e paraqitura. Pika f) NUK plotësohet. Dokumentet fizike të paraqitura përfshijnë certifikime në Identity & Access/Active Directory, SQL/Databaza, Cloud (Azure) dhe Platform management/sales accreditation. Këto nuk janë certifikime në Menaxhimin e Arkivave Digjitale / Records Management (metadata, klasifikim, retention, ruajtje afatgjatë/preservim, audit trail) dhe si rrjedhojë nuk provohen 2 specialistë të certifikuar në këtë fushë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në pikën 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, të shtojcës 9, “Formular i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, autoriteti kontraktor ka kërkuar;

“2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë të punësuar për të paktën muajin e fundit (nga data e publikimit të njoftimit të kontratës) 10 (dhjetë) Specialiste dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

a) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektsh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent.

b) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhimin e Shërbimeve në (ITIL), ose ekuivalent.

c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së skanerit që do të ofertojë, ose ekuivalent.

d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së rrjetit që do të ofertojë, ose ekuivalent.

e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i Netëork Array Storage që do të ofertojë, ose ekuivalent.

f) Të paktën 2 (dy) specialist, të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione certifikuese ndërkombëtare, ose ekuivalent.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesiperm pjesë e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten certifikatat perkatese të kualifikimit/ Transkriptet përkatëse si dhe operatori ekonomik duhet të vertetojë se i ka të punësuar për periudhën e dates se hapjes së tenderit.

Një punonjes mund të ketë një ose disa certifikime, për të përmbushur kriteret e mesiperm për certifikimet. Si përmbledhje, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

• Certifikatat perkatese të kualifikimit / Transkriptet përkatëse për secilin nga specialistet e mesiperm.

• Listepagesat e punonjësve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, për muajin e fundit;

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin).

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, OE ankimues “PC STORE” SHPK, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

• Formulari Përmbledhës të Vetdeklarimit, ku për pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/Kualifikimit” pika B: “ Deklaratë” Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), ka deklaruar: Punonjës

“Po [X] Jo []

Nëse, po, numri i punonjësve: 58 punonjës

Profili i punonjësve: Administrator, Inxhinier elektronik, Teknik elektronik, etj.

Ne kemi punonjësit e nevojshëm të specializuar/ kualifikuar, si më poshtë: duhet të ketë të punësuar për të paktën muajin e fundit (nga data e publikimit të njoftimit të kontratës) 10 (dhjetë) Specialiste dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

a) 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektsh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent.

Rigels Shkempi, Adnant BIBA

b) 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhimin e Sherbimeve në (ITIL), ose ekuivalent.

Rigels Shkempi, Adnant BIBA

c) 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së skanerit që do të ofertojë, ose ekuivalent.

Adnant BIBA, Elton Mehmeti, Rigels SHKEMBI, Lirim BEQO.

d) 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së rrjetit që do të ofertojë, ose ekuivalent.

Liridon Qarkaxhija

e) 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i Netëork Array Storage që do të ofertojë, ose ekuivalent.

Taulant HYKA

f) 2 (dy) specialist, të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione certifikuese ndërkombëtare, ose ekuivalent.

Adnant BIBA, Rudin KURTISHI, Rigels SHKEMBI.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, per te gjithë punonjesit e mesiperm pjese e stafit te punesuar nga vete OE, duhet te paraqiten certifikatat perkatese te kualifikimit/ Transkriptet përkatëse si dhe operatori ekonomik duhet te vertetoje se i ka te punesuar per periudhen e dates se hapjes se tenderit. Nje punonjes mund te kete nje ose disa certifikime, per te permbushur kriteret e mesiperme per certifikimet. Si permbledhje, operatori ekonomik duhet te paraqesi:

- **Certifikatat perkatese te kualifikimit / Transkriptet përkatëse** per secilin nga specialistet e mesiperm.

- **Listepagesat e punonjesve dorezuara nepermjet formes elektronike ne organet kompetente apo cdo dokumentacion tjeter vertetues, per muajin e fundit;**

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST,”

- Gjithashtu nëpërmjet dokumentacionit fizik operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK ka dorëzuar certifikatat si më poshtë:

A) Lidhur me kërkesën “1 specialist i certifikuar për Menaxhim Projektesh PMP, PRINCE2 ose ekuivalent”:

- Project Management (Program Diploma / kurs) – International Business Management Institute (Berlin, Germany) (R. Sh)
- Project Management Fundamentals: Approaches and Frameworks Overview (Alison/CPD) (A. B)

F) Lidhur me kërkesën “2 specialistë të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione ndërkombëtare, ose ekuivalent”:

- One Identity (by Quest)
 - * Active Directory Management & Security – Presales Accreditation (A. B)
- Alison (CPD)
- Digital Imaging v3-02 Digital Imaging Process.(A.B)
 - * IT Management – Software and Databases (A. B / R.Sh)
- Digital Imaging v3-02 Digital Imaging Process.(R.Sh)
 - * Databases – DML Statements and SQL Server Administration (A. B.)
- One Identity / OneLogin
 - * One Identity – OneLogin – Technical Specialist (R. K.)
- Quest
 - * Microsoft Platform Management Sales Accreditation (R. K.)
- Microsoft
 - * Microsoft Certified: Azure Solutions Architect Expert (L. Q.)

III.1.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues

për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.
- Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë

një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në

fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik

dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre

vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e

vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë

një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta,

formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të

zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet, se autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar: *2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë të punësuar për të paktën muajin e fundit (nga data e publikimit të njoftimit të kontratës) 10 (dhjetë) Specialiste dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:*

a) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektesh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent.

b) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhimin e Sherbimeve në (ITIL), ose ekuivalent.

c) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së skanerit që do të ofertojë, ose ekuivalent.

d) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i teknologjisë së rrjetit që do të ofertojë, ose ekuivalent.

e) Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar në nivel teknik profesional nga prodhuesi i Netëork Array Storage që do të ofertojë, ose ekuivalent.

f) Të paktën 2 (dy) specialist, të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione certifikuese ndërkombëtare, ose ekuivalent.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur, konkretisht Formularët Përmbledhës të Vetëdeklarimit, konstatohet, se në lidhje me kërkesën për punonjësit për të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektesh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent , dhe të paktën 2 (dy) specialist, të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione certifikuese ndërkombëtare, ose ekuivalent të kërkuara në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanata të kualifikimit, operatori ekonomik “PC STORE” SHPK ka deklaruar në Pjesën III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit , B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme se ka punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërteton këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, sikurse paraqitet edhe në pikën III.1.2. të këtij vendimi e më konkretisht ankimuesi ka deklaruar: 58 punonjës, nga të cilët për pikën a. Të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektesh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose

ekuivalent ka deklaruar: -Project Management (Program Diploma / kurs) – International Business Management Institute (Berlin, Germany) (R. Sh).

-Project Management Fundamentals: Approaches and Frameworks Overview (Alison/CPD) (A.B). për pikën f) “2 specialistë të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione ndërkombëtare, ose ekuivalent”:

-One Identity (by Quest), Active Directory Management & Security – Presales Accreditation (A. B)

-Alison (CPD)

-Digital Imaging v3-02 Digital Imaging Process.(A.B), IT Management – Software and Databases (A. B / R.Sh)

- Digital Imaging v3-02 Digital Imaging Process.(R.Sh, Databases – DML Statements and SQL Server Administration (A. B.)

-One Identity / OneLogin, One Identity – OneLogin – Technical Specialist (R. K.)

-Quest, Microsoft Platform Management Sales Accreditation (R. K.)

-Microsoft,Microsoft Certified: Azure Solutions Architect Expert (L. Q.). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes nëpërmjet certifikatave të dorëzuar e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për kriterin të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektsh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent. Përsa i përket përmbushjes së kriterit 2 specialistë të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione ndërkombëtare, ose ekuivalent, operatori ekonomik ka paraqitur ndër të tjera certifikatën Digital Imaging v3-02 Digital Imaging Process e cila lidhet drejtpërdrejt me procesin e imazhizimit dixhital. Ky është një certifikim zyrtar nga Ricoh image change. Ajo është një certifikatë që vërteton njohuritë mbi arkivat dixhitale. Referuar certifikatave të dorëzuar nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimes nëpërmjet certifikatave të dorëzuar e përmbush plotësisht kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Kritere teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi për kriterin të paktën 1 (një) specialist, të certifikuar për Menaxhim Projektsh PMP (Project Management Professional), Prince 2 ose ekuivalent, dhe kriterit 2 specialistë të certifikuar në Menaxhimin e Arkivave Digjitale nga institucione ndërkombëtare, ose ekuivalent.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “PC STORE” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e

Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

